



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË



Datë: 02.06.2025

Në bazë të nenit 13, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenit 12, të Rregullores së Ministrisë së Financave dhe Transfereve, MF-Nr.04/2017, të datës 13.06.2017, mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të Organizatave Jo Qeveritare, Rregullores komunale për ndarjen e subvencioneve, nenin 44, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për shpalljen e thirrjes publike për mbështetjen financiare publike për projekt-propozimet e OJQ-ve dhe individëve në fushat e kulturës.
2. Për implementimin e thirrjes publike zbatohen dispozitat e Rregullores mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të Organizatave Jo-Qeveritare dhe individëve si vijon:
 - 2.1 Për realizimin e mbështetjes financiare nga kategoria e subvencioneve për projekt-propozimet në fushën e Kulturës, Rinis dhe Sportit.
 - 2.2 Mjetet për mbështetjen financiare tërhiqen nga kodi i subvencioneve për mbështetjen e entiteteve jopublike dhe individëve që promovojnë avancimin, fuqizimin dhe masovizimin e Kulturës, Rinis dhe Sportit.
3. Afati për dorëzimin e propozimeve për mbështetjen financiare është 5 ditë pune dhe fillon në ditën e publikimit të thirrjes publike. Afati i fundit për dorëzim të projekt-propozimeve është deri me **09.06.2025**.
4. Organizata Jo-qeveritare mund të aplikojnë me vetëm një projekt në kuadër të kësaj thirrje dhe vetëm në njërën nga fushat prioritare sipas thirrjes. Periudha e zbatimit të projektit duhet të jetë minimumi një muaj dhe maksimumi 6 muaj .
5. Propozimet duhet të dorëzohen vetëm në formularët e paraparë sipas udhëzuesit për aplikim.

Dokumentacioni i kompletuar në dy zarfe të mbyllura duhet të dorëzohet në adresën e komunës rruga 'Tahir Zemaj' në Zyrën pritëse për shërbimin e qytetarëve në objektin e komunës ose përmes postës. Çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrën elektronike në email-adresën agron.breznica@rks-gov.net.

6. Vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve e bënë komisioni vlerësues, nëse i plotësojnë kushtet formale për të qenë pjesë e konkurimit sipas paragrafit një të vendimit.
7. Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojnë në përputhje me procedurën e përcaktuar në udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me Rregulloren për financimin publik të Organizatave Jo-qeveritare.
8. Pasi të merret vendimi për financim për aplikuesin e suksesshëm që mund të përkrahet nga kategoria e subvencioneve, projekti i të cilit i plotëson kushtet e financimit, udhëheqësi mbështetur ne rekomandimin e Komisionit Vlerësues merr vendim për ndarjen e mjeteve financiare për financimin e projekt-propozimeve dhe programeve të Organizatave Jo-qeveritare dhe individëve që merren me përkrahjen, fuqizimin dhe masovizimin e Kulturës, Rinis dhe Sportit..
9. Përgjegjës për zbatimin e këtij vendimi është Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport e Komunës së Fushë-Kosovës.
10. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Sqarim: OJQ-të të cilat nuk i kanë mbyllur projektet paraprake (dorëzuar dëshminë e realizimit të projektit dhe raportin financiar) nuk do të shqyrtohen fare nga komisioni për vlerësim.

Akti i dorëzohet:

- 1 x Kryetarit të Komunës**
- 1 x Drejtorisë së FB**
- 1 x Drejtorisë së KRS**
- 1 x Arkivit**

